

Zhvillohet moduli i VI përmblyllës i sesioneve të trajnimit të audituesve të KLSH-së mbi vlerësimin e menaxhimit të risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik në bashkëpunim me ANAC

5-6 qershor 2023

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet prezencës së OSBE-së në Shqipëri, KLSH-së dhe Autoritetit Anti-Korrupsion të Italisë (ANAC), u zhvillua në datat 5-6 qershor 2023 moduli i VI dhe i fundit i trajnimit të audituesve të KLSH-së mbi vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik. Ky modul shënoi përmblylljen e të gjithë ciklit dy-vjeçar të sesioneve të trajnimit në bashkëpunim me ekspertët e Autoritetit Antikorrupsion italian.

Këtë herë u trajtua në veçanti, monitorimi i kontratave publike dhe promovimi i mjeteve digjitale inovative për të përmirësuar auditimin e procedurave të prokurimit. Trajnimi u ofroi pjesëmarrësve mundësinë për të shkëmbyer informacion, për të kuptuar më mirë kuadrin rregullator dhe operacional, standardet ndërkombëtare dhe për të ndarë praktikat e mira me ekspertët e lartë të ANAC.



Aktivitetin e përshëndeti në ditën e dytë znj. Marjola Llanaj, Drejtor i Përgjithshëm i KLSH-së, e cila në fjalën e saj shprehu vlerësimet dhe falenderimet për ekspertizën tepër të vlefshme të ekspertëve të lartë të ANAC, në mënyrë specifike, në dhënien e informacionit dhe eksperiencës nëpërmjet rasteve konkrete të trajtuara, si dhe shprehu bindjen se ky bashkëpunim i suksesshëm tashmë dy-vjeçar do të vijojë më tej, duke mundësuar pika reference dhe modalitete të aplikuara, të cilat do t'i shtojnë cilësi dhe efikasitet qasjes parandaluese që KLSH ka në identifikimin dhe referimin e këtyre rasteve.



Gjithashtu në aktivitetet përshëndeti edhe Zv. Kryetarja e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, znj. Clarisse Pasztory, si dhe anëtari i Bordit të ANAC, z. Paolo Giacomazzo, të cilët theksuan sfidat e prokurimit publik, si edhe rëndësinë gjithnjë e në rritje të transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit në këtë fushë të rëndësishme.



Në përfundim, për të gjithë audituesit u zhvillua ceremonia e dhënies së çertifikatave të pjesëmarrjes në këto sesione tepër të vlefshme trajnimi.

